



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1695 Prot.

Tiranë, më 06 /11 / 2019

V E N D I M

Nr.161 , Datë 06 /11 / 2019

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, mori në shqyrtim ankesën nr.123 regj, datë 02.10.2019, që i përket ankuesve, z.A.S dhe znj. A.S, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “*racës*¹”, nga ana e Shkollës 9-vjeçare “Betim Muço”, Tiranë. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Ankuesi A. S, në në muajin shtator 2019, është paraqitur në Shkollën “Betim Muço”, e cila është në afërsi të banesës së tij, me qëllimin për të regjistruar dy fëmijët e tij, vajzën S. A dhe djalin A. A për klasë të parë. Ai është gjendur në situatë jo favorizuese për shkak të sjelljes jo etike të drejtorit të shkollës, i cili ka hezituuar të regjistrojë fëmijët. Drejtuesi i shkollës ka refuzuar të bëjë regjistrimin e fëmijëve për shkak të mbingarkesës edhe pse fëmijët e ankuesit përmbushin kriteret e pranimit në lidhje me vendbanimin.

Ankuesi ka shkuar për herë të dytë së bashku me aktivistë të organizatës Qendra për Advokim Social, me qëllim regjistrimin e fëmijëve, por përsëri fëmijët nuk u pranuan nga drejtori i shkollës.

¹ Sipas Komisionit Europian kundër Racizmit dhe Intolerancës përkufizimi për “*diskriminimin racial*” është: “*Trajtim i ndryshëm me bazë etninë, origjinën, ngjyrën, shtetësinë, besimin fetar dhe gjuhën*”.

²Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

Për ankuesit përbën problem që t'i regjistrojnë fëmijët në një shkollë tjetër për shkak të distancës fizike që shkollat e tjera kanë me banesën. Ankuesit shprehen se, në këtë shkollë ka fëmijë të tjerë të cilët janë me vendbanim në një zonë tjetër dhe janë regjistruar në këtë shkollë, ndërkohë që fëmijët e tyre që jetojnë afër dhe duhet të kenë prioritet në regjistrim për shkak se i përkasin pakicës kombëtare rome nuk regjistrohen

Në përfundim ankuesit kërkojnë nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe marrjen e masave për regjistrimin e fëmijëve në shkollën “Betim Muço”.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Rezulton nga dokumentacioni i administruar se, ankuesit A.S dhe A.S, janë prindërit e fëmijëve A.A, i datëlindjes 01.12.2011 dhe S.A, e datëlindjes 13.03.2013. Të dy fëmijët kanë mbushur moshën për të filluar klasën e parë. Ankuesit i përkasin pakicës kombëtare egjiptiane, fakt ky që rezulton sipas vërtetimit datë 07.10.2019, të lëshuar nga Qendra për Advokim Social, e cila ka lehtësuar procedurën, duke ndërmjetësuar komunikimin midis ankuesve dhe Komisionerit. Referuar vërtetimeve datë 11.09.2019, lëshuar nga Njësia Administrative Nr.6, Bashkia Tiranë, rezulton se, të dy fëmijët janë banorë të Njesisë Administrative Nr.6. Rregulli për regjistrimin e fëmijëve në klasë të parë, i përcaktuar në nenin 13, të Dispozitave Normative për Sistemin Arsimor Parauniversitar³, përcakton se, regjistrimi i fëmijëve në klasën e parë bëhet duke regjistruar në fillim vetëm nxënësit që i përkasin zonës së shkollës dhe më pas kanë të drejtë të regjistrohen edhe nxënës që u përkasin shkollave të zonave të tjera.

Ligji Nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, rregullon ndër të tjera, zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me racën, ngjyrën, etninë (neni 1⁴). LMD⁵, në nenin 17/1/ç⁶, ndalon çdo lloj dallimi, kufizimi ose përjashtimi gjatë trajtimit që i bëhet nxënësve, duke përfshirë këtu pranimin e tyre në institucionin arsimor, që bazohet në racën, ngjyrën apo etninë. LMD ndalon institucionin arsimor publik të refuzojë pranimin e nxënësve për shkaqet e mësipërme. (neni 17/2⁷)

³ Miratuar me urdhrin nr. 343, datë 19.08.2013, të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, ndryshuar me urdhrin nr. 37, datë 29.01.2018 të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

⁴ Neni 1, të ligjit nr. 10221/2010: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

⁵ Shkurtesë për Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi.

⁶ Neni 17/1/ç, të ligjit nr. 10221/2010: “Ndalohet çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:ç) trajtimin e studentëve ose nxënësve, duke përfshirë pranimin, vlerësimin, zbatimin e masave disiplinore ose përjashtimin e tyre.”

⁷ Neni 17/2, të ligjit nr. 10221/2010: Ndalohet t'i refuzohet një personi ose një grupi personash pranimi në një institucion arsimor publik, për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji.”

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

Neni 7 i LMD-së, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji. Ankesa e paraqitur është konform kërkesave të nenit 33, pika 3, të LMD dhe ajo u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të LMD. Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Në zbatim të nenit 33, pikat 5 e 7, të LMD, me shkresën me nr. 1408/2 prot., datë 04.10.2019, është njoftuar Shkolla 9-vjeçare “Betim Muço”, për paraqitjen e ankesës dhe i është kërkuar që të paraqesë shpjegimet në lidhje me pretendimet e ankuesve.

Më datë 15.10.2019, Qendra për Advokim Social, ka informuar se Shkolla dhe Drejtoria Arsimore, ishin vënë në lëvizje nga ankesa që ishte paraqitur përpara Komisionerit. Ankuesit janë kontaktuar nga Drejtoria Arsimore dhe më datë 14.10.2019, fëmijët A.A dhe S.A kanë filluar shkollën. Me shkresën nr. 128 prot, datë 17.10.2019, protokolluar pranë Komisionerit me nr. 1408/3 prot, datë 21.10.2019, drejtori i Shkollës 9-vjeçare “Betim Muço”, ka informuar se pavarësisht ngarkesës në klasat e para, situata e fëmijëve S.A dhe A.A, është zgjidhur përmes regjistrimit të fëmijëve në klasën e parë. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Shkolla “Betim Muço” dhe konkretisht regjistrimit të klasës së parë, rezulton se fëmijët A.A dhe S.A, figurojnë të regjistruar, në klasën e parë pranë kësaj shkolle.

Neni 33, pika 9 e Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ka parashikuar se: “Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër të cilit është paraqitur ankesa”.

Për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vlerëson, se situata e fëmijëve të ankuesve është rregulluar, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin është nisur ky hetim, në drejtim të regjistrimit të tyre në shkollën “Betim Muço”, Tiranë.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, nenin 33, pika 9 e 10, të ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenin 90, pika 3, të Kodit të Procedurave Administrative, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 123 regjistri, datë 02.10.2019, që i përket ankuesve A.S dhe A.S, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin është filluar procedura hetimore.
1. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

Robert GAJDA

KOMISIONER